

PROTOKOLL

PËR SIGURINË E GAZETARËVE
(ME FOKUS TE GAZETARET)
NË INTERNET



Shoqata e Gazetarëve
të Maqedonisë



Titulli: Protokoll për sigurinë e gazetarëve (me fokus te gazetarët) në internet

Protokollin është përgatitur nga grupi punues i përbërë nga:

- Nikolla Dujovski, Fakulteti i Sigurisë, Shkup i UShKO-së Manastir
- Jasna Baçovska Nediq, Fakulteti Juridik "Justiniani i Parë", Shkup
- Evi Shkopi, gazetare
- Kristina Atovska, gazetare
- Sashka Cvetkovska, gazetare
- Toni Angellovski, Ndihmës i ministrit të Punëve të Brendshme në Departamentin për Marrëdhëniet me Publikun dhe Çështjet Strategjike

Anëtarët e grupit punues nga SHGM:

- Dragan Sekullovski
- Mlladen Çadikovski

Botues: Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Projekti: "Sindikatat për rimëkëmbje të drejtë"

Përkthimi në gjuhën shqipe: Leunora Kaliqi

Dizajni grafik: SHGM

Dhjetor 2022, Shkup

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit rajonal "*Sindikatat për rimëkëmbje të drejtë*" (Sindikatat për rimëkëmbje të drejtë, 1.1.2022-30.4.2023), i financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Konfederatës Evropiane të Sindikatave dhe Federatës Evropiane të Gazetarëve. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë dhe autorëve, si dhe e njëjta domosdoshmërisht nuk i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Konfederatës së Sindikatave Evropiane dhe Federatës Evropiane të Gazetarëve.

Të vetëdijshëm për sfidat serioze dhe kërcënimet në internet me të cilat përballen gazetarët, veçanërisht gazetaret dhe punëtorët e mediave gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre,

Të udhëhequr nga nevoja për siguri më të madhe në internet si parakusht bazë për raportim të lirë dhe të papenguar,

Të gatshëm për bashkëpunim të ndërsjellë i cili do të kontribuojë në mbrojtjen efektive të gazetareve (gra) dhe punëtorëve tjerë të mediave,

Të bindur se vetëm nëpërmjet përkushtimit të plotë të të gjitha institucioneve të përfshira do të mundësohet mbrojtje adekuate dhe funksionim i papenguar i mediave,

Në përputhje me legjislacionin pozitiv të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për publikun prezantojmë

P O T O K O L L

Për sigurinë e gazetarëve (me fokus te gazetaret)
në internet

> FJALA HYRËSE <

Në kohë kur të gjithë kemi mundësinë të ndjejmë se sa mjet i fuqishëm është interneti dhe sa varet zhvillimi i përditshëm i njerëzimit nga ekzistenca e tij, fatkeqësisht kemi mundësinë të ndjejmë edhe anët negative dhe abuzimet të cilat bëhen nga individë të caktuar apo grupe të organizuara, me qëllimin kryesor, që të arrijnë interesat e tyre joparimore duke mohuar jetën moderne demokratike.

Pikërisht gjatë periudhës së hartimit të këtij protokollit jemi dëshmitarë të luftës hibride në të cilën jemi të ekspozuar si shoqëri dhe e cila synon të shkaktojë frikë dhe panik te qytetarët përmes mesazheve të dërguara elektronike me alarme të rrejshme për bomba të vendosura nëpër shkolla, qendra tregtare, objekte me rëndësi jetike për shtetin etj.

Paralelisht me ndërtimin e rezistencës ndaj kërcënimeve hibride ne po ndërtojmë edhe praktika të mira për mbrojtje më të madhe të profesionistëve në media, puna e të cilëve në pjesën më të madhe të kohës lidhet me përdorimin e internetit si mjet i rëndësishëm pa të cilin është i pamundur informimi cilësor, i saktë dhe profesional i publikut. Të dhënat tregojnë se gazetarët, e veçanërisht gazetaret, janë ata që ekspozohen ndaj fyerjeve, presioneve e deri te kërcënimet e shumta që dërgohen nëpërmjet rrjeteve sociale në internet, me qëllimin kryesor, përçarjen e gazetarisë së lirë dhe të pavarur e cila është shtyllë e vlerave demokratike të shoqërisë së vendit.

Gjatë përgatitjes së këtij protokollit janë bërë analiza të gjera dhe është konsultuar literaturë e pasur aktuale, akte ligjore dhe nënligjore, protokolle, udhëzime, rekomandime dhe dokumente tjera, si dhe praktika të shumta institucionale, për të ofruar qasje më të mirë për mbrojtje dhe siguri më të madhe të gazetarëve në internet. Me qëllim që

të ofrohet një pasqyrë e duhur gjithëpërfshirëse e sfidave me të cilat përballen gazetarët, e në veçanti gazetaret, e cila do të mundësojë zhvillimin dhe përpunimin real të rekomandimeve të paraqitura në formën e një Protokollit, me synim kryesor, krijimin e një mekanizmi funksional për siguri më të madhe dhe parandalimin e shkeljeve të të drejtave të gazetarëve (veçanërisht të gazetarëve) nëpërmjet internetit, janë përgatitur analizat e mëposhtme:

- 1. Gjendja me sigurinë e gazetarëve** dhe punëtorëve të mediave në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV) dhe përvojat e tyre gjatë rrezikimit të sigurisë përmes internetit, me fokus në perspektivën gjinore dhe përkatësinë etnike;
- 2. Përvojat e gazetarëve** nga vendet tjera me kërcënimet dhe sulmet në internet;
- 3. Siguria e gazetarëve në internet** nëpërmjet prizmit të zgjidhjeve ligjore dhe me fokus në perspektivën gjinore - në vend, në rajon dhe në BE;
- 4. Protokollet për sigurinë e gazetarëve** dhe punonjësve të mediave në internet dhe dokumente të tjera të ngjashme në rajon dhe BE me fokus në perspektivën gjinore;
- 5. Praktikrat, mundësitë dhe kapacitetet** në Ministrinë e Punëve të Brendshme të RMV-së për mbrojtjen e sigurisë së gazetarëve, në veçanti të gazetarëve në rastet e sulmeve dhe kërcënimeve nëpërmjet internetit.

Analizat siguruan të dhëna të rëndësishme dhe një strukturë të mirë nga e cila u nxorën rekomandimet dhe praktikrat më të mira të cilat janë pjesë përbërëse e këtij Protokollit.

QËLLIMI THEMELOR I PROTOKOLLIT

Siguria e gazetarëve në internet është parakusht themelor për informim të papenguar, profesional, të saktë dhe cilësor të publikut. Duke garantuar sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve të mediave, shteti përmbush premisat bazë të qeverisjes demokratike, ndërsa një shoqëri në të cilën çdo individ do të ndjehet i sigurt në kryerjen e detyrave të punës është aspiratë e të gjitha institucioneve demokratike.

Siguria në internet është sfidë shtesë për shumë arsye. Bota virtuale në të cilën po ndodhin shumë procese të rëndësishme i tejkalon në masë të madhe kufijtë, kapacitetet dhe mundësitë e një vendi apo të rajoneve në Evropë. Çdo vend dhe shpesh shumë institucione evropiane dhe ato ndërkombëtare, i kushtojnë vëmendje të konsiderueshme protokolleve të sigurisë në internet, që synojnë më së shumti mbrojtjen shtesë të kategorive të rrezikuara, veçanërisht të fëmijëve, të institucioneve të sigurisë, të mbrojtjes së infrastrukturës kritike por edhe të një numri të konsiderueshëm të profesionistëve, ndër të cilët, një nga kategoritë e rëndësishme janë sigurisht punonjësit e mediave. Çdo shtet duhet të sjellë masa efektive për mbrojtje kundër sulmeve që synojnë të heshtin ata që ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes duke përfshirë gazetarët, me fokus te gazetaret, një grup që shpesh është i ekspozuar ndaj kërcënimeve, frikësimit dhe sulmeve për shkak të aktiviteteve të tyre. Të gjitha kërcënimet ndaj gazetarëve/eve, pavarësisht nëse realizohen nëpërmjet internetit apo në ndonjë mënyrë tjetër, duhet që të hetohen me energji dhe në kohë të shpejtë, autorët të ndiqen penalisht, si dhe të ofrohet dëmshpërbim adekuat për viktimat apo përfaqësuesit e tyre. Gazetarët/et në disa shtete përballen me arrestime dhe persekutime arbitrare, presione shtypëse politike dhe komerciale dhe rregulla represive. Këto dukuri shkaktojnë frikë dhe pasiguri tek gazetarët dhe punonjësit e tjerë të mediave dhe kanë ndikim shkatërrues në lirinë e shprehjes në tërë shoqërinë.

Kur bëhet fjalë për gazetarët, veçanërisht për gazetaret dhe punonjësit e mediave, prania në internet për shkak të kryerjes së detyrave të punës është imperativ në punë dhe parakusht themelor për sukses në punë. Natyra publike e punës dhe nevoja për të paraqitur të vërtetën çon në faktin se aktivitetet e tyre monitorohen dhe vlerësohen nga një numër i pakufizuar i përdoruesve të internetit (si nga vendi ashtu edhe nga jashtë). Pikërisht ky lloj ekspozimi i gazetareve/punëtorëve të mediave para “gjykatës së publikut” është ajo që shpesh çon në kërcënim potencial për mirëqenien, sigurinë dhe kushtet normale të punës së tyre. Kërcënimet dhe sfidat mund të jenë të llojeve të ndryshme, nga jashtëzakonisht të padëmshme (kryesisht shqetësuese) e deri te kërcënimet serioze, për të cilat duhet të ndërmerren masa penalo-juridike për mbrojtje dhe parandalim.

Duke marrë parasysh këta indikatorë siguria e gazetarëve në përgjithësi, e tani edhe në hapësirën e internetit apo siguria-online e gazetarëve është temë aktuale. Është e pashmangshme ta konsiderojmë atë në kuadrin e rregullimit të mediave-online përmes prizmit të zgjidhjeve ligjore dhe me theks të veçantë në perspektivën gjinore.

Ky protokoll synon të ofrojë zgjidhje e cila do të kontribuojë që çdo gazetar, në veçanti gazetarë, të ndjehet e sigurt por edhe të dijë të veprojë në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve përmes internetit, me qëllim kryesor të marrin mbrojtje adekuate nga institucionet përgjegjëse. Kjo mbrojtje duhet të jetë e plotë dhe afatgjatë, të mundësojë atmosferë pune në të cilën gazetari/ja nuk do të ndërpresë aktivitetet, nuk do të ndryshojë prioritetet apo nuk do të heqë dorë nga hulumtimet apo raportimet e mëtejshme për temën të cilën e trajton.

> KUSHTET AKTUALE <

Mënyra e cila shpesh keqpërdoret për shkeljen e kësaj të drejte të personit tjetër. Derisa një pjesë e shoqërisë po lufton për barazi gjinore, gratë janë viktimat më të zakonshme të sulmeve nëpërmjet platformave në mediat sociale. Të jesh grua dhe gazetare është një “barrë” e dyfishtë sepse ende është objekt më “joshës” i ngacmimeve/sulmeve/kërcënimeve në rrjetet sociale.

Analiza e situatës në vendin tonë dhe në vendet e rajonit tregon se veçanërisht gazetaret janë të ekspozuara ndaj kërcënimeve dhe sulmeve që ndodhin çdo ditë në rrjetet sociale. Rrjetet sociale kanë ofruar një mënyrë të re të lirisë së shprehjes. Çdo ditë, veçanërisht gazetarët/redaktorët/spikerët përballen me presion psikologjik për shkak të komenteve, statuseve apo mesazheve private të dërguara nga individë të caktuar të cilët synojnë t'i heshtin dhe t'i frikësojnë. Caqe më të shpeshta janë gratë në mediat që mbulojnë tema të cilat ndërlidhen me të drejtat themelore të njeriut, tema që tradicionalisht konsiderohen “të përshtatshme për burrat”, tema që ekspozojnë korrupsionin në institucione të caktuara apo individë që abuzojnë me detyrën e tyre, tema që ende konsiderohen si tabu. Fatkeqësisht, tashmë online-ngacmimi i gazetarëve është një fenomen global i cili nuk e ka anashkaluar Maqedoninë e Veriut. Qëllimi i sulmeve të tilla është të heshtin, stigmatizojnë dhe frikësojnë gratë që punojnë në media.

Disa vende kanë arritur më shumë për sa i përket mbrojtjes së internetit, veçanërisht kur bëhet fjalë për gazetaret, ndaj pikërisht shembujt e tillë, të mbështetur në hulumtimet e duhura dhe praktikat e imponuara nga organizatat ndërkombëtare, janë udhërrëfytes për përgatitjen e këtij protokollit dhe për ndërtimin e një qasjeje autentike në vend, për mbrojtje më të madhe të gazetarëve/eve në internet.

Hulumtimet e realizuara kanë treguar pikat “e nxehta” në të gjitha vendet e rajonit, dhe që lirisht mund të themi edhe në një pjesë të mirë të Evropës, për atë se sa i shpeshtë është ngacmimi në rrjetet sociale, prej ku vijnë këto ngacmime, në çfarë forme prezentohen, si reagojnë gazetarët, a i raportojnë këto raste, sa seriozisht i marrin ata apo institucionet, a marrin mbështetje, në çfarë forme dhe nga kush? Sa i konsiderojnë gazetarët “dyert e institucioneve” si adresë të vërtetë kur ka raste të tilla, çka ka të përbashkët në këtë drejtim vendi jonë me vendet fqinje, si i trajtojnë institucionet rastet e tilla atje? Gazetarët përballen me kërcënime të vazhdueshme gjatë punës së tyre si në terren ashtu edhe përmes platformave online. Në terren fyerjet janë më së shumti në formë verbale ndërsa në internet kryesisht kanë për bazë gjininë, por ka edhe nga ato që i referohen përkatësisë etnike dhe fetare, varësisht nga tema që mbulon gazetarja. Pavarësisht se ndjehen të kërcënuar, shumë pak gazetarë i drejtohen autoriteteve për raportimin e rasteve. Edhe kur raportojnë një gjë të tillë, nuk ka epilog. Në disa raste mediat ku punojnë u japin mbështetje morale, por nëse situata është më e rëndë, disa gazetarët shprehen se ndjehen të lënë të vetmuar përballë rrezikut edhe pse arsyeja për të cilën janë kërcënuar është puna që bëjnë. Ata thonë se ndihen të kërcënuar dhe të pambrojtur.

Statistikat e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian tregojnë se gazetaret janë më të ekspozuara ndaj kërcënimeve kundrejt kolegëve të tyre burra, veçanërisht në formën e ngacmimeve online, maltretimeve, përdhunimeve dhe kërcënimeve me vdekje si dhe nxitjes së urrëjtjes së bazuar në gjini. Shpesh këto sulme janë rezultat i fushatave të orkestruara që synojnë diskreditimin ose heshtjen e gazetarëve, të cilat mund të çojnë në autocensurë, tërheqje nga komunitetet-online apo edhe vendimet për t'u larguar nga profesioni i tyre. Gazetarët që raportojnë për tema të cilat ndërlidhen me barazinë gjinore janë veçanërisht të ekspozuara ndaj kërcënimeve dhe hakmarrjes.

Me gjithë mangësitë e shumta është evidente se në vitet e fundit gjërat dukshëm kanë ndryshuar në drejtim pozitiv. Përkatësisht, gjatë vitit 2021 një rast ka përfunduar me aktvendim të prerë në favor të gazetarit të kërcënuar. Një shtetas është dënua me një vit e tetë muaj burg, pasi në vitin 2020 kërcënonte me vdekje përmes aplikacionit "Telegram". Gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021 janë regjistruar gjithsej 23 sulme dhe kërcënime ndaj gazetarëve. SHGM në vitin 2021 ka regjistruar 5 sulme kundër gazetarëve dhe punonjësve të mediave dhe një kërcënim me vdekje, 3 prej të cilëve janë kundër gazetarëve. Bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme po ec pa probleme dhe bazohet në besimin dhe mirëkuptimin reciprok. Fatkeqësisht, mungon bashkëpunim më i ngushtë me Prokurorinë Publike e cila është hallkë kyçe në procedimin e veprave penale që kanë të bëjnë me kërcënimet online ndaj punës së gazetarëve. Gjatë vitit 2022, në bazë të kërkesave të mëparshme të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë si dhe Sindikatës së Gazetarëve, dhe me qëllim të përmirësimit të obligimeve të shtetit në përputhje me rekomandimet për sigurinë e gazetarëve të Këshillit të Evropës, Prokuroria Themelore Publike Shkup caktoi një nga prokurorët publikë si kontaktues për çështje të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e gazetarëve. Ky është një hap pozitiv në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të medias dhe gjithashtu besojmë se me ndryshimet në Kodin Penal dhe futjen e mbrojtjes shtesë për gazetarët dhe punonjësit e mediave do të rritet vetëdijësimi për nevojën që gazetarët të punojnë në media plotësisht të lira dhe në kushte demokratike sipas standardeve të larta botërore.

> SI TË VEPROHET NË RASTET E < KËRCËNIMEVE ONLINE

Përgjegjës për raste të tilla është Departamenti për Krim Kompjuterik dhe Forenzikë Digjitale (DKKFD) pranë MPB-së, por përgjegjëse janë edhe njësitë organizative për krimin kompjuterik pranë departamenteve individuale të punëve të brendshme. DKKFD merr masa pas kallëzimeve për vepra penale në fushën e krimit kompjuterik, të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare. Në lidhje me kërcënimet ose ngacmimet psikologjike, kërcënimet ndaj gazetarëve nëpërmjet rrjeteve sociale, portaleve, faqeve të internetit dhe çdo forme tjetër nëpërmjet internetit, merren masa dhe aktivitete në përputhje me nenin 144 paragrafi 4 “Rrezikim i sigurisë” dhe nenin 394-d “Përhapja e materialit racist dhe ksenofobik nëpërmjet sistemit kompjuterik” dhe me një parashtrësë përkatëse informon PTHP-në kompetente e cila vepron sipas udhëzimeve të dhëna nga Prokuroria Publike.

Në lidhje me procesin e denoncimit, procesverbali i marrjes së një denoncimi dorëzohet në DKKFD ose në stacionin më të afërt të policisë. Nëse ngjarja denoncohet përmes postës elektronike (në adresën cybercrime@moi.gov.mk), ajo shkresë evidentohet nga MPB-ja si parashtrësë dhe veprohet sipas saj. Nëse ajo nuk është e plotë, kontaktohet ai që ka denoncuar për sqarim dhe dorëzim të provave me qëllim që të konfirmohet ngjarja e denoncuar. Po ashtu, me parashtrësën përkatëse njoftohet Prokuroria Publike kompetente dhe respektohen udhëzimet e dhëna nga Prokurori Publik (PP).

Si veprohet konkretisht nëse një gazetar/e denoncon që është në rrezik siguria e tij/saj? Pas pranimin të denoncimit, p.sh., në SPB Shkup, njoftohet menjëherë PP sipas detyrës zyrtare. Njëkohësisht vazhdohet me raportimet policore dhe nëse është e nevojshme bëhet kërkesë apo urdhër nga Prokuroria Publike për sigurimin e të dhënave nga rrjeti social apo nga portali i internetit ku është publikuar kërcënimi.

Në rast se autori njihet, ftohet në intervistë zyrtare dhe nën drejtimin dhe bashkërendimin e Prokurorisë Publike ndërmerren masa dhe aktivitete të mëtejshme, veprime operative dhe hetimore, me qëllim dokumentimin dhe sigurimin e të dhënave dhe informacioneve në cilësinë e provës materiale për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale. Pas dokumentimit të ngjarjes penalo-juridike dhe konstatimit të identitetit të autorit, kallëzimi penal i dërgohet PTHP-së kompetente.

Në procedurën e nisur për sigurimin e të dhënave kompjuterike, PP dhe policia: nuk janë të sigurt nëse ekzistojnë të dhënat e kërkuara, nëse do të sigurohen në bazë të procedurës së nisur, cili është afati real kur mund të pritet që të dhënat e kërkuara do të dorëzohen. Natyrisht, e gjithë kjo ndikon në rrjedhën e procedurës parahetimore dhe hetimore, pasi aktualisht ka raste që nuk kanë përfunduar sepse janë në pritje të përgjigjes nga ofruesit e internetit edhe pse PP dhe policia nuk janë të sigurt nëse do të marrin të dhënat e kërkuara. Njëkohësisht, ka raste që nuk mund të kryhen me efikasitet pikërisht për shkak se mungojnë të dhënat kompjuterike, të cilat nuk janë kërkuar në kohën e duhur. Ajo që duhet theksuar në mënyrë të veçantë është se: është ulur efikasiteti në zgjidhjen e rasteve për të cilat është e nevojshme të sigurohen të dhëna kompjuterike, të cilat mund të paraqesin prova potenciale në procedurë.

> TË NDËRTOJMË NJË QASJE MË TË < MIRË PËR MBROJTJEN E GAZETARËVE/ EVE NË INTERNET

Egzistojnë në thelb përvoja të shumta që tashmë janë aplikuar në vende të tjera, disa prej tyre me rezultate të mira, disa me të kufizuara dhe disa pa ndonjë ndikim të theksuar në sigurinë më të madhe të gazetarëve/eve në internet. Përgjigje e suksesshme ndaj këtyre kërcënimeve moderne është e mundur vetëm nëpërmjet përfshirjes së plotë dhe profesionale të gazetarëve/gazetareve, redaktorëve, pronarëve të mediave, policisë, Prokurorisë Publike dhe autoriteteve të tjera kompetente shtetërore. Mendimi ynë është që disa nga përvojat të cilat mund të jenë reale, të matshme dhe të zbatueshme edhe për rastet dhe nevojat tona janë:

HAPI 1 - DENONCIMI:

A) Krijimi i kulturës për mbrojtje nga kërcënimet në internet në redaksi. Duke pasur parasysh se gazetaret kalojnë një pjesë të madhe të kohës së tyre të punës në redaksitë e tyre dhe ndajnë shumë aktivitete të përbashkëta me kolegët e tyre, mendimi ynë është se ky hap është bazë për ndërtimin e një qasjeje e cila do të parandalojë pasojat e kërcënimeve të mundshme. Mbështetja në redaksi nuk duhet të mungojë, gazetarja besimin më të madh e ka te njerëzit e saj të dashur, te redaktori, te menaxheri i medias ku punon. Ata do ta mbështesin në procedurë, menjëherë dhe pa vonesë për ta denoncuar rastin në polici dhe që gazetarja e sulmuar të mbrohet për periudhë të caktuar. Kolegët dhe redaktori duhet të vlerësojnë se si gazetarja po përballet me kërcënimet, nëse asaj i nevojiten hapa shtesë për mbështetje ose mbrojtje dhe nëse ajo i ka të gjitha resurset për t'u marrë me këtë situatë. Ata duhet të jenë në kontakt të vazhdueshëm me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe au-

toritetet e tjera për zbatimin e ligjit, të interesohen për rastin dhe të ofrojnë mbështetje për mbrojtje shtesë;

B) Krijimi i linjave dhe kanaleve të qarta të denoncimit. SHGM do të ofrojë mbështetje të plotë për gazetaret që do të jenë cak i kërcënimeve në internet. Linja e përhershme telefonike në të cilën çdo gazetarë do të mund të drejtohet për mbështetje dhe këshilla do të jetë në shërbimin tuaj për çdo informacion, si dhe asistencë ligjore falas që për anëtarët e SHGM-së ju ofron një avokat. Nga mënyra e denoncimit në polici, ofrimit të mbështetjes ligjore dhe psikologjike, hapave të tjerë procedural dhe deri te disa këshilla praktike për sigurinë personale të gazetarit/es. Ministria e Punëve të Brendshme ka caktuar një person kontaktues nga DKKFD për gazetarët dhe gazetaret që do të marrin kërcënime në internet, me mbështetje për procedurat e sigurisë, raportimin e rastit, mbrojtjen e provave, sigurimin në kohë të të gjitha informacioneve të mundshme etj. Ky aktivitet është konfirmuar pas marrjes së pëlqimit nga Byroja e Sigurisë Publike në MPB.

C) Dokumentimi i çdo rasti individual të një sulmi ose kërcënimi nëpërmjet internetit. MPB tashmë dokumenton të gjitha raportimet e marra për kërcënime në internet por është e nevojshme të vendosen procedura të qarta që do të rrisin besimin në kapacitetet e policisë. Policia duhet të jetë në koordinim të vazhdueshëm me Prokurorinë Publike dhe faktorët e tjerë vendor dhe ndërkombëtar dhe të punojë në mënyrë aktive për gjetjen e shpejtë të autorit të veprës penale dhe procedimin e tyre në Prokurorinë Publike kompetente. SHGM gjithashtu mund të mbajë një regjistër të veprave të raportuara penale të kryera kundër gazetarëve në internet. Sipas këtyre të dhënave si dhe përditësimit të dosjeve, SHGM do të ketë qasje dhe mund të interesohet në emër të gazetares se deri ku është rasti dhe nëse po ndërmerren masa të vazhdueshme për gjetjen dhe kapjen e autorit.

HAPI 2 - VLERËSIMI I RREZIKUT:

A) Rreziku nga lëndime fizike. Sipas mesazhit të marrë, MPB do të bëjë një analizë rrisht nëse ka mundësi që kërcënimet në internet të kalojnë në terren dhe gazetarja të kërcënohet fizikisht (ajo apo një person i afërt i saj), si dhe të vlerësohet se a ka nevojë të rritet siguria e personit konkret i cili është cak i kërcënimit. Kjo veçanërisht është e rëndësishme nëse kemi parasysh se pothuajse pa përjashtim në të gjitha rastet e vrasjeve dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve/eve DKKFD, ata kanë qenë edhe më parë objekt i kërcënimeve në internet.

B) Rrezik nga pasojat psikologjike. Çdo kërcënim serioz mund të ketë pasoja psikologjike. Varësisht nga aftësia për t'i rezistuar kërcënimeve të tilla, reagimi psikologjik i personit të sulmuar mund të jetë nga i lehtë në të moderuar, e deri në situatë jashtëzakonisht shqetësuese, në të cilën vihet në pikëpyetje aftësia e gazetares për të kryer përkohësisht detyrat e saj. Në çdo fazë të rikuperimit, gazetarja do të merr mbështetje të plotë për ballafaqim më të lehtë me pasojat.

C) Rreziku nga dëmtimi i reputacionit. Kjo sfidë është gjithmonë e pranishme, por fakti që gazetarët janë edhe persona publik të ekspozuar vazhdimisht ndaj "grykimit të publikut", ata nuk kanë nevojë të shqetësohen shumë për dëmtimin e reputacionit, sidomos për pikëpamjet e shprehura nga persona anonimë, qëllimi i të cilëve është pikërisht të diskreditojnë çdo person që nuk punon sipas qëllimeve të tyre të shkrura.

HAPI 3 - MEKANIZMAT NDIHMËS:

A) Mbështetja për sigurinë digjitale;

B) Mbështetja ligjore;

- C) Mbështetja emocionale dhe psikologjike;*
- D) Pushimet e përkohshme, ndryshimi i lokacionit ose ndryshimi i vendit të punës;*
- E) Sigurimi i mbështetjes publike;*
- F) Zbutja e sulmeve përmes internetit;*

Të gjithë hapat e shënuara në mekanizmat ndihmës kanë të njëjtin synim - ndërtimin e një qasjeje, e cila do të ndryshojë ndjeshëm rrethanat e punës në kushtet e kërcënimeve në internet, kështu që nëse ato përpunohen në detaje dhe zbatohen plotësisht, do të mundësojnë një përgjigje të qartë e cila shkon përtej kufijve të një redaksie, një mediumi, një ministrie, por do të përfaqësojë përgjigjen tonë të përbashkët shoqërore dhe garancinë për gazetari të lirë dhe të pavarur.

HAPI 4 - NDJEKJA DHE RIVLERËSIMI / ROLET DHE DETYRAT

- A) Koordinator për mbrojtjen në internet;*
- B) Menaxhmenti;*
- C) Redaktorët;*
- G) Moderatorët;*
- D) Gazetarët;*

Ky hap i referohet forcimit të kapaciteteve të mediave dhe punonjësve të tyre. SHGM mund të ndihmojë në rast se kërkohet ndihma e tyre, veçanërisht në përgatitjen e programeve dhe planeve të trajnimit, si për gazetarët ashtu edhe për redaktorët dhe ekipet menaxhuese të mediave profesionale. Redaktorët kanë një rol shumë domethënës në procesin e forcimit të kapaciteteve të mediave, veçanërisht në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të punonëtorëve. Ata duhet të jenë mjaftueshëm të trajnuar dhe të përgatitur për procedurat dhe veprimet për denoncimin e kërcënimeve në internet. Shqetësimi i tyre duhet të jetë i përhershëm dhe është mirë që të

jenë të gatshëm të mbështesin gazetaren e cila ka marrë kërcënime si dhe të vendosin kapacitetet e medias për mbrojtje dhe kujdes më të mirë ndaj punëtores.

Interneti çdo ditë po ndryshon dhe po merr gjithnjë e më shumë nga hapësira e lirë. Në kushte të tilla edhe mediat duhet të ndryshojnë, të shfrytëzojnë përfitimet e botës moderne dhe të vendosen në drejtim të qasjes moderne, tërheqëse, të hapur për të mbështetur çdo gazetare që përballet me ndonjë kërcënim.

> NË VEND TË PËRFUNDIMIT <

Gjërat të cilat duhet t'i kushtoni vëmendje të veçantë janë:

- 1. Mbështetja për gazetaret**, pjesëtarët e kategorive të rrezikuara dhe gazetaret të cilat raportojnë për çështje gjinore - ato më së shpeshti janë të ekspozuara ndaj kërcënimeve në internet;
- 2. Transparenca** dhe denoncimi i rasteve të sulmeve dhe/ose kërcënimeve - pa asnjë vonesë dhe llogaritje, e as me mosbesimin që policia nuk do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për gjatjen dhe kapjen e autorit të veprës;
- 3. Faktori kohë** - koha e denoncimit nuk guxon të prolongohet, ndonjëherë minutat janë të rëndësishme ndërsa sekondat vendimtare për suksesin e hetimit;
- 4. Fushata për të rritur ndërgjegjësimin** dhe për të ofruar informacione - fushatat gjithmonë japin rezultate. Më shumë fushata, me më shumë informacion, të cilat do të arrijnë sa më shumë njerëz në kohën e duhur dhe veçanërisht gazetarët dhe gazetaret e interesuara;
- 5. Sulmet-online** ndaj gazetarëve përmbajnë edhe gjuhë të urretjes, e cila rrit shtrirjen e veprave penale ndaj gazetarëve por edhe mundësinë e gjatjes së autorit;
- 6. Dhuna-online** në Maqedoninë e Veriut dhe në rajon çon në autocensurë dhe bën që gazetaret të shmangin temat e politikës së lartë, por gjithashtu çon edhe në tërheqjen e grave nga jeta publike;
- 7. Sulmet ndaj gazetarëve** shpesh orkestrohen nga qendrat e

pushtetit (partitë, korporatat e biznesit), kështu që përgjigja duhet të synojë mbrojtjen nga sulmet e tilla.

- 8. Është e nevojshme të futen mekanizma** të gjerë të brendshëm për mbrojtjen e gazetarëve/gazetareve në internet.
- 9. Ndryshimet në Kodin Penal** dhe Ligjin për Procedurë Penale pritet të mundësojnë mbrojtjen penalo-juridike të gazetarëve si persona zyrtarë, dhe me këtë të përshpejtohen të gjitha proceset që zhvillohen për mbrojtjen e gazetarëve/gazetareve.
- 10. Përveç SHGM-së** edhe vetë mediat duhet të marrin rol më aktiv në mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve të medias.
- 11. Vërejtjet kryesore të palëve të prekura** kanë të bëjnë me moszbatimin, mosndëshkimin ose zbatimin selektiv të Kodit Penal, Ligjit për Shpifje dhe Fyerje, praktikën e dobët në zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi në internet, shkeljet e përditshme dhe evidente të Ligjit për të Drejtat Autoriale.
- 12. Është i nevojshëm rregullimi apo vetërregullim** shtesë i hapësirës mediatike me udhëzime dhe rekomandime që do të qartësojnë dyshimet e shumta që kanë të bëjnë me zbatimin e standardeve gazetareske të punës/shkrimit në internet, përkatësisht në: burimet e informacionit, mënyra se si transmetohen përmbajtjet mediatike, respektimi i privatësisë, respektimi i autorësisë dhe çështje tjera të rëndësishme klasike.
- 13. Mbrojtja efektive e gazetarëve/gazetareve** në hapësirën kibernetike do të jetë detyrë prioritare, por në të njëjtën kohë nuk duhet të rrezikojë lirinë e të shprehurit. Filtrimi dhe bllokimi

i përmbajtjes në internet, veçanërisht në rrjetet sociale, do të jetë një sfidë e veçantë.

14. Sistem trajnimi për gazetarët, oficerët e policisë dhe profesionistët e tjerë në organet e zbatimit të ligjit, të cilët do t'i bëjë të ndjeshëm në çështjet për sigurinë në internet.

15. E fundit, por jo më pak e rëndësishme - përfshirja aktive e PTHP-së si partnere e SHGM-së dhe MPB-së në luftën për mbrojtje më të madhe të gazetarëve dhe punëtorëve mediatik, të cilët janë bartës të vlerave demokratike në shoqërinë tonë.



www.znm.org.mk

Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë

Gradski dzid, blok 13 1000 Skopje

00389 (02) 3298-139

contact@znm.org.mk